



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2013

Lënda: Analiza Vjetore Janar –Dhjetor 2013 e ZSHDA

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), në bazë të Ligjit nr. 9380, dt.28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, si institucioni shtetëror kompetent që monitoron dhe kontrollon respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura në territorin e RSH, Ju informon mbi aktivitetin e saj për vitin Janar – Dhjetor 2013 si më poshtë:

I. Zhvillimet legislative – Draft Ligji për të Drejtën e Autorit, harmonizmi i tij me direktivat e BE dhe *acquis communautaire*.

Ligji Nr. 9380, date 28.04.2005 mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të është **pjesërisht i përputhur me Acquis Communautaire**. Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit në përputhje me detyrimet e Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së ka patur detyrimin e hartimit të një ligji të ri i cili duhet të jetë në përputhje me Direktivat e Bashkimit Europian.

Ndërkohë në kuadër të Projektit IPA 2008 “Për forcimin e kapaciteteve të ZSHDA” një ekip me ekspertë nga më të mirët e kësaj fushe kanë përfunduar hartimin e draftit të ri të Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të, i cili përputhet dhe transponon në mënyrë të plotë Direktivave të BE, si dhe implementon në të, praktikatat më të mira administrative, gjyqësore dhe të zbatimit të të drejtave në tërësi.

Prioriteti kryesor i Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit në muajt e parë të vitit 2013 ka qënë puna me draft ligjin e ri, ku janë inkuorporuar në të të gjitha komentet dhe sugjerimet e ardhura nga institucionet që merren me zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit si dhe nga të gjitha grupet e interesit.

Pas inkuorporimit të sugjerimeve të grupeve të interesit, projekt ligji është dërguar nga ZSHDA-ja në MTKRS në datë 24.10.2012. Në muajin maj të vitit aktual, projektligji është përcjellë nga MTKRS-ja për në Këshillin e Ministrave, i cili është shprehur nëpërmjet shkresës Nr. 1624/1 Prot., datë 22.05.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për mosreflektimin në tekstin e projekt-ligjit “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura” të sugjerimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Financave.

Pas përcjelljes në ZSHDA të kësaj shkrese nga MTKRS-ja, zyra i është drejtuar të fundit si dhe në dijeni Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave mbi evidentimin e sugjerimeve

përkatëse të tyre në projektligj. Ministria e Drejtësisë është shprehur mbi shkresën tonë në korrik 2013, shkresë të cilën ZSHDA-ja ia ka përcjellë MTKRS-së, duke mbetur në pritje të njoftimit të hapave të tjerë lidhur me këtë projektligj, duke qënë se për të është ngritur një grup pune në muajin maj, me Urdhër të Ministrit të TKRS.

II. Sektori i Regjistrim - Çertifikim – Inspektimit / Statistika mbi inspektimet dhe numrin e gjobave të vendosura


Përsa i përket monitorimit të tregut nëpërmjet inspektimit dhe marrjen e masave administrative për subjektet që nuk kanë përmbushur detyrimet që burojnë nga Ligji nr.9380, date 28.04.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” gjeni informacionin e detajuar për 6-të mujorin e parë të vitit 2013, si më poshtë:

I

1. Inspektime, Konstatime, njoftime;

Gjatë ushtrimit të kontrollit ndaj subjekteve tregtare, u monitoruan dhe u kryen inspektime në **29 (njëzet e nëntë) subjekte tregtare**, te cilat shfrytëzojnë programe kompjuterike gjatë aktivitetit të tyre për qëllime përfitimi.


Nga kjo kategori janë gjobitur **4 (katër) subjekte**.



Në vazhdim të inspektimeve, janë informuar me qëllim sensibilizimin e subjekteve për zbatimin e ligjit shqiptar për të drejtën e autorit nëpërmjet shkresave tip **50 (pesëdhjetë) subjekte**.

Kategorië që u informuan paraqiten më poshtë;

Inspektim për sensibilizimin, kategorite e subjekteve



Shkresa Tip

Lënda: Kujtese për zbatimin e ligjit nr.9380, date 28.04.2005 “ Per te Drejten e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te lidhura me te”

Drejtuar: _____


Zyra Shqiptare për te Drejtat e Autorit , si institucion publik që monitoron zbatimin e ligjit nr. 9380, date 28.04.2005 “ Per te Drejten e Autorit dhe te Drejtat e Tjera te lidhura me te”, bazuar në nenin 114/2 dhe 130(LDA), si edhe te VKM 232, date 19.04.2006, pika 16 dhe 52, si subjekt përdorues i pronesise artistike, letrare, shkencore, ju rikujton detyrimin për te shpërblyer Mbajtesit e te Drejtave mbi veprat Artistike, Muzikore, Letrare apo Shkencore dhe Agjencite e Administrimit Kolektiv për te Drejtat e Autorit dhe te Drejtave te tjera te lidhura me te, për veprat që shfrytëzoni , si dhe për depozitimin e ketyre kontratave në Zyren Shqiptare për te Drejtat e Autorit(ZSHDA).

Për sa më sipër dhe në zbatim të ligjit, merrni masat për përmbushjen e detyrimeve tuaja ligjore.

Faleminderit për mirekuptimin.

Gjatë ushtrimit të kontrollit ndaj subjekteve tregtare, u monitoruan dhe u krye inspektimi në **10 (dhjetë) subjekte tregtare**, të cilat tregtojnë pajisje kompjuterike dhe gjatë aktivitetit të tyre posedojnë, shpërndajnë, shesin programe kompjuterike për qëllime fitimi. Subjektet e inspektuara janë monitoruar nga Inspektorët e ZSHDA, ku dhe janë mbajtur proces-verbale përkatëse dhe janë sqaruar në lidhje me detyrimet ligjore që ka çdo subjekt për zbatimin e të drejtës së Autorit.


Subjektet janë të kategorive si më poshtë ;



Përsa i përket kategorive Bare-Hotele-Radio-Qendra Tregtare, Pika Shitje CD-DVD, Ritransmetues kabllor, Televizione, të kryera në qytetet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë.


Tiranë

Inspektime




Durrës

Inspektive




Vlorë

Inspektive




Përsa i përket kategorive Universitete Librari, Kancelari, Qendra Fotokopjimi, Shtëpi botuese ,subjektet janë të rradhitura si më poshtë:



Në vazhdim të punës Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit ka kryer inspektime edhe në kategoritë ; shtëpi prodhuese, vidioteka , pika shitje cd/dvd të cilat në ushtrim të aktivitetit të tyre prodhojnë , shesin, shpërndajnë, japin me qera vepra artistike, si muzike, filma etj, të mbrojtura nga ligji nr.9380, date 28.04.2005.

Gjatë këtij inspektimi është ushtruar kontroll në 18 subjekte , 9 Prodhues dhe 9 Pika Shitje.

Inspektim,Shtëpi Diskografike dhe Pika Shitje CD/DVD



7

Nëpërmjet inspektimit ju kërkua subjekteve prodhuese të fonograeve të paraqiten në ZSHDA Brenda 15 ditëve me kontratat përkatëse që kanë me mbajtësit e të drejtave për shfrytëzimin e veprave artistike që hedhin në treg (CD-DVD), Gjithashtu edhe pikave të shitjes së produktit ju theksua detyrimi ligjor për shitje të CD DVD, me filma , muzikë etj, sipas parashikimeve të LDA, në të kundërt ZSHDA do të marrë masa administrative me gjobë kundrejt çdo shkelësi të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

Inspektime të kryera në Durrës.

Në qytetin e Durrësit janë kryer 26 inspektime në kategoritë Bar-Kafe, Restorante dhe Hotele ku inspektorët e zyrës në bazë të Planit të punës ju kanë bërë me dije subjekteve zbatimin e Ligjit Shqiptar për të drejtën e Autorit.

Inspektime në Durrës




Inspektim i subjekteve “Televizione”, Durrës

Inspektim i kryer me ankese te F.M.A.A

II

1. Inspektime te kryera gjatë vitit 2013

Jane inspektuar **302 subjekte** te kategorive te ndryshme. Kategorite e inspektimeve jepen grafikisht me poshte:



2.Masa administrative

Kemi mare masa administrative ne subjekte qe jane konstatuar shkelje administrative dhe kemi ndeshkuar me gjobe ne baze te nenit 130 te ligjit 9380 date 28.04.2005.

Konkretisht jepen ne tabelen e meposhtme:

Subjektet	Masa
Call-Center	3
Spital Privat	1
Videoteka (Durrës)	4

3.Njoftime

Per programet kompjuterike krahas inspektimeve jane njoftuar per detyrimet ligjore me shkrese **850 subjekte** tregtare qe gjate aktivitetit te tyre shfrytezojne/perdorin programe kompjuterike, konkretisht:

Shkurt: 530 subjekte (shkrese)

Mars: 320 subjekte (shkrese)

III

1. Analizë e inspektimeve të kryera.

Në inspektimet e kryera lidhur me shfrytëzimin e programeve kompjuterike është konstatuar kjo problematikë lidhur me disa kategori të ndryshme shfrytëzuesish:

Banka, paraqesin situatën më të mire në treg lidhur me licensimin e programeve kompjuterike dhe kanë shkallën më të ulët të piraterisë. Blerja e sistemeve operativ dhe serverave ka qënë nga kompanitë mëmë në Greqi, Austri dhe Itali.

Gjatë inspektimit të kryer në 6-të mujorin e dytë dhe në vitin 2012 nuk janë verejtur përdorime të programeve pirate.

Kompani Sigurimi, tendenca e shfrytëzimit të programeve kompjuterike të licensuara ka qënë më e ulët se në Banka, në nivel qëndror të kompanive të sigurimeve ku edhe është kryer inspektimi situata paraqitet e mirë. Në nivel pikash të cilat shtrihen në qytetet e ndryshme të Shqipërisë në baze të dokumentacionit të depozituar në ZSHDA, situata është problematike.

Vlen te përmendet gadishmeria për përmbushjen e detyrimeve që rjedhin nga LDA nga ana e kompanive me miratimet e buxheteve ku parashikojnë si zë edhe licensimen e programeve të tyre.

Call-Center, Subjektet që përdorin sisteme të licensuara janë te pakta. Gjithashtu vlen per tu theksuar qe kjo kategori subjektesh ka bërë kthim sistemesh operativ nga Windows në Linux,Ubuntu pasi ky system është falas.

Spitale dhe Klinika, përdorimi I sistemeve operative ka qënë I kufizuar në shumicën e tyre (përdoret vetëm në administratë dhe kanë qënë të licensuar) pasi kishin në përdorim vetëm programe teknike dhe server te licensuar(Spitalet) pasi mbrojtja e të dhënave te pacientit ishte me rëndësi të vecantë.


AAK- Problemi më i madh i Inspektimit dhe monitorimit të tregut të ZSHDA, është mungesa e Agjencisë së Autorëve, Aktualisht nuk ka Agjenci të licensuar sipas LDA për Administrimin Kolektiv të të Drejtave të Autorit.

LIBRI- Situata në treg sin ë Librari apo pika tregtimi të ndryshme paraqitet e mirë, deri më sot nuk ka raste të tregtimit të Librave të fotokopjuar, të konstatuar nga ZSHDA.

Shtëpitë Botuese- Problematika e hasuur me Botuesit qëndron në faktin e mos depozitimit të librit për Rastet e Cilësimit si mbajtës të drejtash, kjo me qëllim Identifikimin në rastet e shfrytëzimit nga të tretë. Pamvarësisht pretendimeve të Shtëpive Botuese, ZSHDA ka Inspektuar dhe ka kërkuar nga këta të fundit të Raportojnë veprat të cilat ata kanë konstatuar veprat e tyre, por në asnjë rast nuk është paraqitur rast Konkret.

2. Përfundime

Nga inspektimi i kryer ne 29 subjekte shfrytezues / perdorues te programeve kompjuterike kane bere kthim pergjigje dhe kane ndryshuar situaten nga inspektimi 19 subjekte



REGJISTRIMI I TË DREJTËS SË AUTORIT DHE KALIMIT TË TË DREJTAVE.

Në Zyrën Shqiptare për të drejtën e Autorit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2013, janë regjistruar-çertifikuar sipas klasifikimit administrativ, si më poshtë;

Regjistrim-çertifikim të drejtë autori ;

Janë regjistruar dhe çertifikuar **55 (pesëdhjetë e pesë)** çertifikata të drejtë Autori.

Regjistrim-çertifikim kalim të drejtash pasurore;

Janë regjistruar-çertifikuar **19 (nëntëmbëdhjetë)** çertifikata kalim të drejtash pasurore.

Regjistrim objekt veprimtarie;

Janë regjistruar **12 (dymbëdhjetë) subjekte të ndryshme.**

Gjatë kësaj periudhe janë refuzuar për regjistrim-çertifikim një numër i madhë kontratash për kalim të drejtash pasurore, gjatë shqyrtimit të këtyre kontratave rezultoi se nuk ishim bërë sipas parashikimeve të ligjit nr 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera, të lidhura me të”, i ndryshuar, dhe legjislacionit civil ne fuqi, për të cilat janë dhëne shjegimet me shkresë nga ana e ZSHDA mbi arsyet e refuzimit të këtyre kontratave.

Përsa i përket regjistrimit-çertifikimit të objekt veprimtarisë te subjekteve që shfrytëzojnë vepra letrare, artistike ose shkencore, në bazë të ndryshimit të nenin 130, të ligjit nr 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera, të lidhura me të”, regjistrimi dhe çertifikimi i objekt veprimtarisë nuk është më i detyrueshëm për subjektet e ndryshme,

Janë në proces regjistrimi-çertifikimi një numër i konsiderueshëm aplikimesh, ku pasi të shqyrtohet dokumentacioni i nevojshëm do të procedohet me regjistrim-çertifikimin e veprave të ndryshme sipas klasifikimit administrativ,

Duke marrë parasysh shqetësimet e shumë autorëve të veprave të ndryshme letrare, artistike, shkencore, sektori i regjistrim-certifikimit ka dhënë të gjithë ndihmesën e duhur për të orjentuar drejtë autorët mbi të drejtat dhe detyrimet që ato kanë mbi veprat e tyre në bazë të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, gjithashtu subjekteve juridike që kanë si objekt veprimtarie prodhuese, tregtare apo çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, artistike ose shkencore, u është dhënë ndihma e nevojshme nga ana e ZSHDA për problemet që ato hasin gjatë aktivitetit të tyre tregëtar, në raport me të drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të.

III. Sektori i Gjykimi dhe Administrimit të Ankesave

1. Procedimet administrative:

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar **15 (pesëmbëdhjetë) procedime administrative**, nga të cilat:

- **4 procedime administrative, kanë përfunduar në favor të palës ankimuese.**

Pasi është zhvilluar procesi administrativ dhe janë shqyrtuar të gjitha provat në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjit “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta e Tjera të Lidhura me të”, SMAA-ja ka shprehur qendrimin e saj me aktin “Shpjegim Përfundimtar” në favor të palës ankimuese.

(Ankimues Bashkim Kozeli kundër palës së ankimuar Teatri Kombëtar; Ankimues Yzeir Llanaj kundër palës së ankimuar “Elrodi Music”; Ankimues Keti Sala kundër palës së ankimuar Revista “Story”)

Nga këto, 1 (një) procedim administrativ vazhdonte që nga viti 2012. *(Viktor Papa – Gazeta 55)*

- **3 procedime administrative janë zgjidhur me mirëkuptim mes palëve.**

SMAA-ja pasi ka zhvilluar seancat dëgjimore, i ka shpjeguar të dyja palëve në proces të gjithë hapat proceduriale që do të ndërmerren në procesin administrativ dhe veprime të tjera ligjore që palët mund të zgjedhin të ndjekin.

Pas këtyre bisedimeve palët e kanë zgjidhur me mirëkuptim konfliktin objekt shqyrtimi. *(Ankimues Blerina Goce kundër palës së ankimuar Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”; Ankimues Saimir Kumbaro kundër palës së ankimuar “News 24”; Ankimues Gjon Neçaj kundër palës së ankimuar shtëpia botuese “Erik”)*

- **4 procedime administrative janë pushuar sipas kërkesës së palës ankimuese.**

Gjatë procesit administrativ 2 prej ankimuesve kanë kërkuar pushimin e procedimit pasi nuk kanë mundur të provojnë pretendimet e tyre (neni 82 e në vijim i Kodi të Procedurës Administrative) ose kanë zgjedhur t’i drejtohen organeve gjyqësore apo hetimore.


(Ankimues Luljeta Dino kundër palës së ankimuar subjekti “Gurten”; Ankimues Artan Hajdari kundër palës së ankimuar Qendra e Realizimit të Veprave të Artit; Ankimues “Eni Music Network” kundër palës së ankimuar “Albatrade Plus”; Ankimues Ardian Trebicka kundër palës së ankimuar “Akademia Kult”)

- **3 procedime administrative nuk janë marrë në shqyrtim nga ZSHDA për mungesë juridiksioni/kompetence.**

3 ankesa janë paraqitur pranë SMAA-së, dhe kjo e fundit në përmbushje të nenit 75 të Kodit të Procedurës Administrative ka verifikuar juridiksionin dhe kompetencën për të shqyrtuar ankesën. Ka rezultuar se ZSHDA-ja nuk ka pasur juridiksion për shqyrtimin e këtyre ankesave. Dy prej këtyre ankesave po gjykohen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

(Ankimuesi Ervin Gonxhi kundër palës së ankimuar “Acromax” Ghmb; Ankimuesi Flori Mumajesi kundër palës së ankimuar “Acromax” Ghmb; Ankimuesi Ervin Gonxhi kundër palës së ankimuar “Acromax” Ghmb)

- **1 procedim administrativ** është marrë në shqyrtim, por në seancën e parë dëgjimore rezultoi se nevojitej akti i ekspertimit për të konstatuar nëse kishte cenim për të drejtat e autorit. Si pasojë , palët ranë dakord ta dërgojnë në gjykatë.
(Ankimues Syrja Sukaj kundër palës së ankimuar Shoqërisë Genklaudis)



(Paraqitja e grafike e numrit të procedimeve administrative që nga viti 2010)

- **Problematika e ndeshur gjatë shqyrtimit të ankesave, është ajo që ka shoqëruar të gjitha procedimet administrative të zhvilluara deri më tani, si:**
 - Paraqitja e disa kërkesave ankimore të paplota, pra jo në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative;
 - Mosparaqitja e provave që në seancat e para nga pala ankimuese, për të vërtetuar cënimin e së drejtës së autorit/të drejtave të tjera të lidhura me të, e cila sjell zgjatjen e procedimit;
 - Mosparaqitja në seancë administrative e palës së ankimuar e cila sjell zgjatjen e procesit administrativ.

2. Proceset gjyqësore:

Spektori i Monitorimit dhe Administrimit të Ankimeve (SMAA) ka përfaqësuar ZSHDA-në në **14 (katërbëdhjetë) procese gjyqësore**, si më më poshtë:

- **Në 6 (gjashtë) procese gjyqësore ku ZSHDA-ja ka qënë palë e tretë, prej të cilave:**

2 (dy) procese kanë përfunduar në favor të të dëmtuarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

2 (dy) procese gjyqësore janë pushuar pasi nuk është paraqitur paditësi

2 (dy) procese gjyqësore janë ende duke u gjykuar pranë Gjyqësorit, një prej të cilëve po gjykohej në Dhomën Penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- **Në 4 (katër) procese gjyqësore ZSHDA-ja ka qënë në pozicionin procedural të paditurit apo paditësit, si më poshtë:**

2 (dy) procese gjyqësore kanë përfunduar në favor të ZSHDA-së.

1 (një) proces gjyqësor është pushuar pasi pala paditëse nuk u paraqit në seancën gjyqësore.

1 (një) proces gjyqësor Gjykata ka vendosur në favor të palës paditëse.

- **5 procese gjyqësore janë zhvilluar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga të cilat:**

1 (një) proces gjyqësor po rigjykohej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me tjetër trup gjykues.

4 (katër) procese gjyqësore kanë përfunduar në favor të ZSHDA-së

3. Detyra të tjera të SMAA-së:

Gjatë kësaj periudhe, specialistet:

- Kanë ndjekur ekzekutimin e gjobave pranë Shërbimit Përbarimor Privat.
- Kanë marrë pjesë në hartimin dhe në përpunimin e projektligjit për të drejtat e autorit.
- Kanë marrë pjesë në takime ndërinstucionale për përpunime legjislacionesh të ndryshme lidhur me pjesën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, takime të ndryshme me organizata si dhe institucione të huaja.
- Gjithashtu, Sektori në tërësi ka përbushur me efikasitet të plotë edhe punën rutinë administrative të institucionit në lidhje me shkresat me subjektët përdorues në fushën e përdorimit të LDA-së.

IV. Sektori i Monitorimit të Agjensive të Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura

Lidhur me administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to mund të themi se deri më 1 shtator 2013 funksiononin 4 agjensi të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura në Republikën e Shqipërisë, konkretisht:

- ❖ “Albautor” në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj,
- ❖ “FMAA” për mbrojtjen e regjisorëve dhe skenaristëve të kinematografisë shqiptare dhe audiovizualit
- ❖ “AKDIE” për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues
- ❖ “AMP” për të Drejtat e Prodhuesve të fonogramit.

Mbi Agjensinë ALBAUTOR!

Agjencia Albautor, ka funksionuar si “Agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj”, në bazë të rilicencimit të saj, me urdhër të Ministrit të TKRS, të botuar në fletoren zyrtare, **Nr. 109, datë 16.08.2010 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në këtë fletore, pra në datë 01.09.2010.**

Ndodhur në këto kushte ZSHDA njofton se duke qënë se janë përmbushur 3 vjet nga dhënia e kësaj licence me Urdhër të Ministrit të TKRS, pra i ka kaluar periudha e vlefshmerisë së saj si licencë, në bazë të neni 109, pika 2 të LDA, agjencia “Albautor” nuk gëzon më asnjë të drejtë për të vepruar si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave, duke filluar që nga data **01.09.2013.**

Për çdo ndryshim lidhur me aplikimin apo procedura te tjera në lidhje me këtë agjenci, ZSHDA-ja do të bëjë njoftimin përkatës për të gjithë të interesuarit.

Gjatë periudhës së parë të vitit ZSHDA i ka Propozuar Ministrit të Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve pezullimin e licencës së agjencive “Albautor” dhe “AKDIE” për periudhën 6-mujore, parashikuar në pikën 2 të Nenit 116, si afat i fundit i agjencive për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Ky propozim ka ardhur si shkak i moszbatimit të Ligjit “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhur” dhe Statuteve të agjencive “Albautor” dhe “AKDIE”, të tilla si:

1. Mospërmbushje e detyrimit për të mbledhur nga përdoruesit të ardhurat dhe shpërndarjen e tyre titullarëve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, në përputhje me dispozitat statutove dhe tarifave të deklaruara;
2. Mospërmbushjen e detyrimit për të depozituar në ZSHDA informacionin e kërkuar në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së tyre;
3. Depozitimimin në ZSHDA të çdo autorizimi të lëshuar me faturë tatimore;
4. Mosdepozitimimin e listës së tarifave të miratuara nga agjencitë;
5. Mospërmbushjen e detyrimit për thirrjen çdo vit kalendarik të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, e cila duhet të miratojë buxhetin e Agjensisë dhe listën e shpërndarjeve;

Ky propozim i është dërguar në datë 10.10.2013, me shkresën Nr. 1038 Prot. Deri në datën e sotme, nuk është dhënë ende një urdhër i autoritetit të Ministrit të MTKRS për pranimin ose jo të propozimit të ZSHDA-së për pezullimin e licencës së këtyre dy agjencive, megjithëse Drejtoria Juridike që ka shqyrtuar çështjen, është shprehur me shkrim për pranimin e këtij propozimi të zyrës.

Lidhur me agjencinë “ALBAUTOR”, theksojmë se afati i vlefshmërisë së Licencës së saj si agjencie, ka përfunduar në datë 01.09.2013. ZSHDA-ja ka publikuar në faqen e saj elektronike, njoftimin për përmbushjen e këtij afati.

Sa i takon veprimtarisë së agjencive për vitin financiar 2012, ZSHDA-ja në kuadër të Ligjit të fushës, ka vijuar të kryejë kontrollin e bilanceve të këtij viti si dhe ka kërkuar informacione sqaruese, plotësim dokumentacioni etj. Deri më tani ZSHDA-ja ka përfunduar raportin për veprimtarinë e agjencisë “AMP” për vitin financiar 2012 .

Ndërkohë që mbeten ende në proces shqyrtimi kontrolli i dokumentacionit të tri agjencive të tjera për të cilat, megjithë kërkesat e vashdueshme të ZSHDA-së për plotësimin e paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar, ende nuk i kanë paraqitur ato.

V. **Kuadri ndër - kombëtar i bashkëpunimit me organizmat e huaja.**

ZSHDA ka patur vëmendjen dhe mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale që në momentin e krijimit të saj deri më sot, (WIPO/OBPI).

OBPI (www.wipo.int) është organizata më e madhe botërore që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale. Është një agjensi e specializuar e Kombeve të Bashkuara. I është dedikuar zhvillimit të një sistemi ndërkombëtar të balancuar dhe të aksesueshëm të pronësisë intelektuale, e cila do të thotë shpërblim, stimulon dhe nxit krijimtarinë, kontribuon në zhvillimin ekonomik duke ruajtur interesat publike.

Komisioni European ka qënë një tjetër partner drejt së cilës është shtrirë kërkesa jonë për bashkëpunim.

ZSHDA bashkëpunon në mënyrë të rregullt me USAID, Microsoft Albania, Dhomenë Amerikane të Tregtisë etj, me të cilat ka patur bashkëpunime të frytshme.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizmat e lartpërmendur janë organizuar këto aktivitete

- *Më datat 11- 12 mars* u zhvillua një “Seminar për bashkëpunimin e institucioneve zbatuese” në kuadër të Zhvillimit të Sistemit të të Drejtave të Pronësisë Industriale, Ky aktivitet është në kuadër të projektit të BE si dhe në bashkëpunim me Zyrën e Markave dhe Patentave. Në këtë seminar ishin të pranishëm inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit.
- Përsa u takon trajnimeve dhe përmirësimit të kapaciteteve institucionale administrative dhe në këtë periudhë ka vazhduar bashkëpunimi me Microsoft dhe BSA Albania për të trajnuar inspektorët e ZSHDA mbi njohuritë e programeve kompjuterike dhe sofëare, si dhe për të dalluar kur një program i tillë është i piratuar apo jo – origjinal (Fake) .
- Në kuadër të forcimit dhe bashkëpunimit të mëtejshëm midis institucioneve shtetërore të cilët merren me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e pronësisë intelektuale, ZSHDA ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e këtyre institucioneve për të ri-forcuar detyrimet përkatëse që burojnë nga Memorandumet e Nënshkuara.
- Në kuadër të promovimit të PI, me 18 Prill 2013 u mbajt një Konferencë, organizuar nga Komisioni European dhe Zyra e Markave dhe Patentave, ku ndër të ftuarve të tjerë të pranishëm, Drejtori i ZSHDA-së Z. Mujë Buçpapaj, mbajti një fjalim duke përcjellë mesazhe të qarta për krijimtarinë njerëzore dhe përfitimet që sjell në ekonominë e një vendi dhe civilizimin e shoqërisë, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.
- “IP Street Promotion”-18 prill 2013, ZSHDA në bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave ka organizuar ngritjen e stendave me qëllimin

promovimin e PI në Pedonalen e Tiranës duke shpërndarë materiale promociuale dhe informative rreth çështjeve të të drejtës së autorit për komunitetin në përgjithësi.

- Në kuadër të bashkëpunimit me organizma e shoqata të tjera, vlen të përmendet ndërveprimi me USAID/Albania, i cili në bashkëpunim me ATA dhe ZSHDA-në kanë zhvilluar workshope në Tiranë, në Durrës dhe Vlore (perkatesisht ne datat 16, 19 prill dhe 9 maj 2013) me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për komunitetin e Biznesit (hotele, bare restorante) kundrejt detyrimeve qe kane kundrejt ligjit per te drejten e autorit.
- Në datën 7 Gusht 2013, u zhvillua nje trajnim nga Inspektorati Qendror i tregut për inspektorët e ZSHDA në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe procedurat e të vepruarit në momentin kur trupat inspektuese janë para subjekteve.
- Në kuadër të aktiviteteve që ofron Bashkimi European, nëpërmjet programit të Asistencës Teknike TAIEX/KE, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit ka qënë përfituese e një workshop-i ndër-Rajonal “*Mbi zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura*” nga institucionet shtetërore zbatuese. Ky aktivitet u organizua më datat 16 -17 Shtator 2013, në Tiranë. Qëllimi i këtij workshopi ishte shkëmbimi i praktikave dhe eksperiencave më të mira dhe forcimi i autoriteteve shtetërore zbatuese midis Vendeve të Ballkanit Perëndimor (Bosnia/Herzegovina, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Shqipëria).
- Më datë 9 Tetor 2013 në Tiranë, u zhvillua “*Seminari Kombëtar mbi të drejtën e autorit dhe përjashtimet dhe kufizimet për personat me dëmtime ne shikim*” Ky aktivitet u mbështet nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI) ne bashkëpunim me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit. Ky event vjen në kuadër të promovimit të Traktatit të Marokut, i cili u nënshkrua këtë vit nga 51 shtete me 28 qershor 2013, pas shumë vitesh bisedimi dhe konsultimi midis palëve kontraktuese dhe negociatorëve mes 186 shteteve anëtare të WIPO. Qëllimi i këtij aktiviteti është rritja e kapaciteteve , mbrojtja e të drejtës së autorit dhe rritja e mundësive per këdo, duke përfshirë personat me dëmtime në shikim / dhe paaftësi për të printuar për të shijuar artin dhe jetën kulturore të komunitetit ku bën pjesë.
- Më datë 26 Shtator 2013 u zhvillua në Shkup /Maqedoni “Konferenca e V-të Rajonale e IFPI per raportimin e shteteve dhe Agjencive te Administrimit kolektiv të territorit të Ballkanit. Ky aktivitet u organizua nga Federata Ndërkombëtare e Industrisë së Fonogramave (IFPI) . Në këtë event ishin të ftuar dhe përfaqësues nga ZSHDA dhe Agjensi të menaxhimit kolektiv. Kishte dhe të ftuar nga Agjensite homologe te administrimit kolektiv të Kroacise, Sllovenisë, Kosovës, Maqedonisë etj. Qëllimi i eventit ishte rritja e bashkëpunimit dhe ndarja e praktikave me të mira midis agjensive të administrimit kolektiv ashtu si dhe për të ndërtuar një dialog konstruktiv të mëtejshëm midis agjensive dhe Zyra Shtetërore te Pronësisë Intelektuale në Rajon. Temat e diskutuara në axhendë ishin si legjislative ashtu dhe operacionale te cilat janë të një rëndësie të vecantë për krijimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të agjensive eficente. Fakt i rendesishem i cili u theksua per Agjencite Shqiptare të Administrimit Kolektiv ishte se duhet qe te bashkepunojne me njera tjetren nepermjet sistemit ONE STOP SHOP - pra funksioni në një sportel të vetëm, që do të thotë subjektet duhet te paguajnë një shumë totale në një llogari dhe më pas kjo shumë ndahen midis agjensive përkatëse sipas përqindjeve që iu njeh ligji.

- Më datat 7-8 Tetor 2013 u mbajt në Tiranë një Workshop i organizuar nga SCAPR (Shoqëria për agjensitë e menaxhimit kolektiv të të drejtave të interpretuesve) në bashkëpunim me AKDIE (Agjensia për mbrojtjen e të drejtave të artistëve dhe të interpretuesve). Aktiviteti u ndoq nga një përfaqësues i zyrës. Pika kyce e të gjithë konkluzioneve ishte nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore të cilat janë pjesë e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale veçanërisht në respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura.
- Më datat 2 – 3 Tetor 2013 u mbajt në Budapest, Hungari një Konferencë Rajonale mbi dizajnin industrial. Qëllimi i kësaj konference ishte për të nxitur/promovuar dizajnin industrial dhe për të promovuar këtë fushë si burim i mirëqenies, punësimit dhe zhvillimit shoqëror. Kjo konferencë u ndoq nga një përfaqësues i ZSHDA. Gjatë konferencës u diskutuan gjerësisht aspekte të ndryshme të Dizajnit Industrial, duke i kushtuar kujdes të veçantë rolit të aktorëve të ndryshëm në këtë industri në rritje
- Më datat 14 – 16 Tetor 2013 u mbajt në Hagë, Hollandë një Konferencë në lidhje me “Workshop ndër - Rajonal mbi Krimin Ekonomik” Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria e Zgjerimit të Komisionit Europian brenda kuadrit të Instrumentit të Asistentës Teknike TAIEK. Nxitur nga shqetësimet dhe rreziqet ndaj stabilitetit të BE-së dhe sigurisë që parashtrihen nga krimi ekonomik, dhe krimet të organizuar në veçanti, Konferenca tërhoqi pjesëmarrës nga 19 vende, kryesisht jo- shtete të BE-së, duke përfshirë Shqipërinë, me qëllim ndërtimin e urave me partnerët e ardhshëm të mundshëm të zbatimit të ligjit. Axhenda e Konferencës mbuloi një shumëllojshmëri të gjerë të subjekteve, duke i informuar pjesëmarrësit për mjetet kryesore të BE-së, legjislacionin dhe mundësitë për bashkëpunim për zbatimin e ligjit. Workshopi 2- ditor dha një pasqyrë të veçantë të zonave të kriminologjisë atij ekonomik të tilla si produkte të falsifikuara, dhe prezantimet e ekspertëve ndihmuan pjesëmarrësit për të kuptuar çështjet e vërteta të përfshira në parandalimin dhe kontrollin e këtyre krimeve të rënda, dhe ndihma në dispozicion të tyre.
- Më datat 28 - 30, Tetor 2013 u mbajt në Podgoricë/ Mal i Zi, një Seminar mbi “*Kuadrin ligjor dhe promovimin e përmbytjes kinematografike dhe audiovizuale*” Qëllimi ishte rritja e ndërgjegjësisë midis vendim –marrësve të Vendeve të Ballkanit Perëndimor mbi nevojën për të investuar në ruajtjen, dixhitalizimin, përdorimin dhe menaxhimin e trashëgimisë së tyre kulturore dhe për të promovuar shpërndarjen e praktikave të mora dhe për të forcuar aftësitë e profesionistëve që punojnë në qendrat e arkivave dhe në fushën e transmetimeve. Një përfaqësues i ZSHDA-së referoi në këtë aktivitetet kuadrin ligjor për përdorimin e veprave kinematografike dhe audiovizuale.
- Më data 13- 15 nëntor 2013 një grup ekspertësh i Komisioni Europian kanë mbërritur në Tiranë dhe kanë marrë takime apo sic quhet ndryshe “Peer to Peer assesment” me të gjithë institucionet shtetërore, pjesë e zbatimit në fushën e Pronësisë intelektuale. Ky grup ekspertësh ka marrë takim dhe me përfaqësues të Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit ku janë njohur me problematikën dhe vështirësitë që has ky institucion në kryerjen e detyrave të saj. Pritet që ky mision vlerësimi ekspertësh të dalë me një raport mbi Pronësinë Intelektuale për Shqipërinë.
- Procesi i Integritimit

Gjatë kësaj periudhe është përditësuar Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Është raportuar në mënyrë periodike sa i takon monitormit të progres raportit të Shqipërisë lidhur me angazhimet që ajo ka në kuadër të antaresimit në BE dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA.

➤ Marrëdhëniet me median dhe shtypin e shkruar

Një ndër qëllimet kryesore të ZSHDA, është institucionalizmi dhe ngritja në një nivel të kënaqshëm i prezantimit të aktivitetit të saj në publik. Kjo Zyrë ka detyrim të saj, jo vetëm të realizojë transparencën ndaj publikut, por kryesisht të kryejë një proces sensibilizues, i cili të synojë rritjen e nivelit të njohurive dhe të përgjegjshmërisë, jo vetëm tek strukturat shtetërore zbatuese, të cilat do të lidhen në zinxhir bashkëpunimi me ZSHDA, por dhe ndaj operatorëve ekonomikë, mbajtësve dhe përdoruesve të pronësisë intelektuale (të drejtës së autorit) dhe komunitetit në përgjithësi për krijimin dhe kultivimin e një kulturë sa i takon fushën së të drejtave të autorit.

VI. MBI REALIZIMIN E DETYRAVE NË SEKTORIN E FINANCËS

Specialisti i financës ndjek problemet financiare në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore mbi përdorimin dhe menaxhimin e fondeve të miratuara.

Kryen veprimet me thesarin, ndjek në mënyrë periodike detajimin e buxhetit, shpenzimet financiare dhe përgatit formularin për realizimin e shpenzimeve dhe pasi rakordon çdo muaj me thesarin e dërgon në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në MTKRS.

Plotëson në mënyrë periodike pasqyrat statistikore dhe i paraqet ato në afatin e caktuar pranë drejtorisë përkatëse.

Përgatit listë-pagesën e punonjësve, kryen veprimet me thesarin, bankën dhe bën kontabilizimi e tyre në librat përkatëse.

Ndjek likuidimin e të gjitha faturave për shpenzimet e kryera nga institucioni brënda afateve të përcaktuara.

Përgatit listë-pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore çdo muaj dhe i dorëzon ato pranë Drejtorisë së Tatim Taksave.

Plotëson dokumentacionin mbi realizimin e të ardhurave që realizohen nga ofrimi i shërbimeve të specializuara dhe kuadron çdo muaj me specialisten e thesarit.

Përgatit kërkesat buxhetore për vitin pasardhës në kuadër të Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale".

Jep asistencë në Sektorin e Monitorimit të Agjensive të Adminisrimit Kolektiv mbi kontrollin e bilanceve të agjensive në bazë të pasqyrave financiare dhe informacionit të dërguar prej tyre.

Kryhen veprimet në librat e kontabilitetit, si kontabiliteti i bankës, arkës, magazinës dhe kontabiliteti i përgjithshëm.

Rregjistrimi i pagave në librin e pagave çdo muaj.

Përgatit pasqyrat financiare vjetore në mbështetje të të dhënave të kontabilitetit dhe të inventarit që paraqiten pas mbylljes së çdo ushtrimi vjetor,

Përgatit bilancin financiar dhe e dorëzon në thesar për miratim dhe në drejtorinë përkatëse në MTKRS.

Për periudhën janar – dhjetor 2013 shpenzimet e institucionit janë realizuar si më poshtë:

Paga dhe shpërblime personeli, plan=12.196 mijë lekë, fakti= 12.173 mijë lekë, (realizuar **99.8%**)

Sigurimet shoqërore e shëndetsore, plani = 1.959 mijë lekë, fakti =1.918 mijë lekë, (realizuar **97.9%**)

Shpenzime operative plani = 1.527 mijë lekë, fakti = 1.526 mijë lekë, (realizuar **99.8%**)

Realizimi i fondeve është bërë brënda limiteve të përcaktuara nga MTKRS.

Shpenzimet e bëra për periudhën janar-dhjetor 2013 janë të kuadruar me degën e thesarit.

Zyra shqiptare për të Drejtat e Autorit siguron të ardhura nga ofrimi i shërbimeve të specializuara subjekteve të ndryshme, sipas tarifave të miratuara për këto shërbime në VKM nr. 343, datë 06.06.2007 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit”, ndryshuar me VKM nr. 461, datë 16.4.2008.

Të ardhurat e institucionit për vitin 2013 janë realizuar në shumën prej lekë të detajuar si më poshtë:

-shërbime të ndryshme	94,925 lekë,
-pulla artistike	1,988 lekë,
-gjoba	350,000 lekë

Në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2007 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, pika a, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit.

Duke Ju falenderuar,

MUJË BUÇPAPAJ

Drejtori